

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-05/2021	Data: Datum: 11.01.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorisë për Administratë Komunale për formin e komisionit për pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës: Lot 1 "Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale", me numër prokurimit 633-20-7024-221/FA071 dhe me numër të brendshëm 633/020/113/221 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET** Komisioni për pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës: Lot 1 "Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve të institucioneve Komunale" me numër prokurimit 633-20-7024-221/FA071 dhe me numër të brendshëm 633/020/113/221 dhe në Komision caktohen:

1. **Bashkim Haxhiaj**, Zyrtar për Transport 1, Kryesus i Komisionit;
2. **Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë, anëtar;
3. **Xhevat Idrizaj**, Zyrtar për Pylltari 2, anëtar;


2. Komisioni i cekur më lartë, ka për obligim që të bëjë pranimin e punëve për servisimin e automjeteve të komunës sipas kontratës së cekur, të kontrollojë se cilën pjesë të venë në automjetin e servisuar, si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për servisimin e automjeteve të komunës e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

5. Vendimi është perfundimtar

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Administratë Komunale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


 Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-06/2021	Data: Datum: 11.01.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.06-016/374490 të datës 01.12.2020, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Deçanit, për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për znj.Shefki Hasanmetaj nga fshati Strellcë i Epërm, Komuna e Deçanit dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-016/374490 të datës 01.12.2020, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Deçanit, për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për znj.Shefki Hasanmetaj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovare e lindur me 10.01.1952, në fshatin Përqevë komuna Klinë.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e përherëshëm te te larteceukres.
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj znj.Shefki Hasanmetaj, gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjendjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.06-016/374490 të datës 01.12.2020, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale ne Deçan, për strehimin e të moshuarëve, shqyrtoi dosjen e znj.Shefki Hasanmetaj e cili jeton në fsh.Strellc i Epërm Deçan” në shtëpi te ish-bashkëshortit, jeton në një dhomë të veçant ka edhe një banjo në shfrytëzim pra ajo jeton e vetëm pa përkujdesje nga askush.

Gjendja shëndetësore e saj për momentin është e mirë pa probleme mendore, statusi familjar nuk ka bashkëshort, fëmijë biologjik as të adoptuar nuk ka vëllezër dhe as motër, ka qenë fëmija i vetëm ne shtëpi pas vdekjes se prindërve, por qe ka pasur martesë te mëhershme disa here, por te gjitha pa fëmije.

Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ne mënyre te përherëshme vendosjen e saj pas shqyrtimit te dosjes dhe gjendjes shëndetësore te saj, me ç ’rast ka konstatuar se duhet t’i lejohe strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: znj.Shefki Hasanmetaj, Islam Mustafaj-Drejtor i QPS-së në Deçan, QPS Istog, Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-07/2021	Data: Datum: 12.01.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj shkresën e KQZ Nr.21/2021 të datës 08.01.2021 për caktimin e një zyrtari ndërlidhës me KQZ-në dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** zyrtar ndërlidhës me KQZ-në Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim Publik në Komunë.
2. Kontakti tel. +38349252739; email: ardonarifaj@gmail.com.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Ardon Arifaj.
4. Vendimi është perfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ardon Arifaj, KQZ-ja dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA





 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-06-1360 Data 12.01.2021
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-22/021	Data: Datum: 15.01.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria Komunale për Arsim, shqyrtoi kërkesën 05.Nr.553-1127 të datës 11.01.2021 të parashtruar nga Naxhije Gjocaj nga fsh. Tomoc, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzës Hana Gjocaj në qëndren rabilituese në Klinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.553-1127 e datës 11.01.2021, e parashtruar nga Naxhije Gjocaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzës Hana Gjocaj në rrahbilitim në qëndren ditore në Klinë pasi që e njehta është me autizëm dhe i lejohen nga 50 litra karburant në muaj dhe atë deri me 31.07.2021.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë Naxhije Gjocaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Naxhije Gjocaj, ka parashtruar kërkesën 05.Nr.553-1127 e datës 11.01.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i vajzës së saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Hana është e sëmure dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj në qendren rrahbilituese në Klinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Klinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmenduren më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja Komunale për Arsim do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Naxhije Gjocaj, Drejtoria Komunale për Arsim, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-31/021	Data: Datum: 18.01.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 12.01.2021 të parashtruar nga KQZ përmes Armanda Loshi Zyrtare e Lartë e Zgjedhjeve, për mbështetje të Komisionit Komunal për Zgjedhje për lejimin e shfrytëzimit të automjetit të komunës, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e KQZ për mbështetje të Komisionit Komunal për Zgjedhje dhe i lejohe shfrytëzimi i automjetit CITROEN 03Z-07-06, i cili është në pronësi të komunës.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit në sasi sipas nevojës në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Komisioni Komunal për Zgjedhje mundet të shfrytëzoj automjetin e lartëpërmendur për nevojat e komisionit deri sa të kryhen zgjedhjet parlamentare.
4. Automjetin mund të ngas zyrtari i cili caktohet nga KKZ si dhe anëtarët e komisionit.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Përgjegjësi i Autoparkut.
6. Ky vendim është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetarja e KKZ-së, Përgjegjësi i Autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr33/021	Data: 22.01.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit 05.Nr.14/2021 të datës 22.01.2021, për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Shefqet Mavraj, me titull të postit: Mësimdhënës i Edutatës Figurative në Shfmu "Ismail Qemali" në Saradran, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.14/2021 e datës 22.01.2021, e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në lartësi prej 3(tri)pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Shefqet Mavraj, me titull të postit: Mësimdhënës i Edukatës Figurative në Shfmu "Ismail Qemali" në Saradran.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 13.02.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Shefqet Mavraj, t'ia bëjë pagesën, e 3 (tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Shefqet Mavraj, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-34/021	Data: Datum: 25.01.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-2554 të datës 20.01.2021 të parashtruar nga Adem Demaj nga Dobrusha, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindërit për dializë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-2554 të datës 20.01.2021 të parashtruar nga Adem Demaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindërit për dializë dhe i lejohet 57 litra karburant për muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që Adem Demaj, të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Adem Demaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-2554 të datës 20.01.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i prindërit për dializë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Mustafa është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për dializë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për dializë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmenduren më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Adem Demaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ





Kryetari i Komunës
Haki RUCOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.36/021	Data: Datum: 27.01.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në paragrafin 4 të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe në nenin 49 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), shqyrtoi kërkesën Nr.01-016-3364 të datës 27.01.2021, të parashtruar nga Jeta Balaj-Imeraj, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, për ndërprerjen e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** Kërkesa Nr.01-016-3364 të datës 27.01.2021 e parashtruar nga Jeta Balaj-Imeraj, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, për ndërprerjen e pushimit të lehonisë pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve.
2. Jeta Balaj-Imeraj, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, i ndërprehet pushimi i lehonisë pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve dhe obligohet të dalë në punë me datë 01.02.2021, nese nuk lajmerohet në punë me këtë datë dhe nuk paraqet ndonjë arsye konsiderohet se ka hequr dorë nga marrëdhënia e punës.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Menaxheri i Personelit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi në Komisionin për ankesa dhe parashtrës.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: Jeta Balaj-Imeraj, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]

